


1400 ps 01/04/2026



Në bazë të neneve 11 dhe 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 2 pika j) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.28/2008), nenit 6 paragrafët 2.1. dhe 6, nenit 7 të Ligjit nr.04/L-010 për bashkëpunimin ndërkomunal (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.7/2011), si dhe nenit 13 pika i) të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 01.04.2026, merr këtë:

VENDIM NR.13/2026/KG
për miratimin e nismës për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal

Neni 1

Me këtë vendim miratohet nisma e kryetarit të komunës për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal midis Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Leposaviqit.

Neni 2

Qëllimi i vendosjes së bashkëpunimit ndërkomunal sipas këtij Vendimi është bashkëpunimi në fushat e menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhimit financiar dhe zbatimit të prokurimit publik.

Neni 3

Kryetari i Komunës së Graçanicës, me një vendim të veçantë të Kuvendit të komunës, do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me komunën e lartpërmendur dhe përgatitjen e propozimit të marrëveshjes për bashkëpunimin e ndërsjellë.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević